

Rinumërohen 13 nga
50 vendvotime që i takojnë
komunës së Vushtrrisë,
procesi vazhdon



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM I NATO-S, MARK RUTTE,
KA QËNDRUAR TË MARTËN PËR VIZITË NË KOSOVË

SEKRETARI I NATO-s THOTË SE PËRPARIMI NË DIALOGUN KOSOVË - SERBI KËRKON FLEKSIBILITET DHE KOMPROMISE

FAQE 4-5



Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Mark Rutte, ka thënë të martën në Prishtinë se dialogu në mes të Kosovës dhe Serbisë është e vetmja mënyrë për t'i zgjidhur çështjet e hapura, duke shtuar se kërkohet fleksibilitet dhe

kompromis. Në konferencën e përbashkët për medie me presidenten Vjosa Osmani në Prishtinë, Rutte ka deklaruar se stabiliteti në rajonin e Ballkanit Perëndimor varet nga të gjitha palët, duke zgjedhur "diplomacinë në

vend të dhunës". Rutte u shpreh se prania e tij në Kosovë është demonstrim i qartë i përkushtimit të palëkundur të NATO-s për siguri afatgjatë në gjithë Kosovën, pastaj edhe për stabilitetin e rajonit

**ABDIXHIKU: LDK-ja
NUK ËSHTË PJSË E
ÇFARËDO ZGJIDHJE
KU NUK UDHËHEQ
QEVERINË** F.7



**KOSOVA
PËRKUJTON
44-VJETORIN E
DEMONSTRATAVE
TË VITIT 1981** F.7



RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net / www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shagiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

OPINION

KOMANDANT NENADI! F.8

Behxhet Sh.
SHALA - BAJGORA



AKTUALE



**WALTZI KONFIRMON PËRPARIM NË
BISEDIMET SHBA - UKRAINË** F.5

**GAZETA BRITANIKE: SHOIPËRIA,
NDËR VENDET MË TË MIRA PËR
TË UDHËTUAR NË VITIN 2025** F.5

EKONOMI



**DINARI SERB, I NDALUAR NË
RREGULLORE, I PRANUAR NË TREC** F.8

**ATK-ja BËN THIRRJE TË
DEKLAROHEN TË ARDHURAT
DHE TË PAGUHEN TATIMET** F.7

SPORT



**DRITA FITORE ME AROMË TITULLI
NDAJ BALLKANIT, FERIZAJ
MPOSHTI LLAPIN** F.6

Waltzi konfirmon përparim në bisedimet ShBA - Ukrainë

UASHINGTON, 11 MARS - Këshilltari i Sigurisë Kombëtare në Shtëpinë e Bardhë, Mike Waltz, tha të martën se Shtetet e Bashkuara po përparojnë në bisedimet që po zhvillojnë me një delegacion të lartë ukrainas që po mbahet në qytetin Xhedah të Arabisë Saudite. E sekretari amerikan i Shtetit, Marco Rubio, që po udhëheq delegacionin amerikan, nuk iu përgjigj pyetje të gazetarëve. Takimi filloi në mesditë, sipas

orës lokale, në qytetin buzë Detit të Kuq. Palët vendosën të zhvillojnë një pauzë pas mbi 3 orësh e gjysmë bisedimesh. Andriy Yermak, shef i kabinetit të presidentit ukrainas Volodomyr Zelensky, pjesë e delegacionit ukrainas, në rrjetin social X shkruante “në punë e sipër”. Yermak, gjithashtu, ka vlerësuar se “takimi ka filluar në mënyrë shumë konstruktive”. Gjatë takimit delegacioni ukrainas pritet të



prezantojë një plan të pjesshëm armëpushimi me Rusinë. Plani ukrainas përfshin ndalimin e sulmeve

me raketa me rreze të gjatë dhe një armëpushim që mbulon Detin e Zi. Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky nuk mori pjesë në takimin e së martës. Ukraina u përfaqësua nga shefi i tij i personelit Andriy Yermak, ministri i Jashtëm ukrainas Andrii Sybiha, ministri i Mbrojtjes Rustem Umerov dhe komandanti Pavlo Palisa. Para takimit, presidenti Zelensky shkroi në “X” se Ukraina shpreson për “rezultate praktike”.

Ukraina kryen sulm masiv me dronë në Moskë

KIEV, 11 MARS - Ukraina ka kryer sulm masiv me dronë në Moskë dhe rajonin e saj, duke vrarë të paktën tre persona dhe duke dëmtuar ndërtesa të banimit dhe infrastrukturë tjetër, teksa diplomatët prej Uashingtonit dhe Kievit përgatiten për t'u takuar në Arabinë Saudite. Sipas Andrei Vorobyovit, guvernatorit të rajonit të Moskës, dhjetëra persona janë plagosur në sulmet që kanë ndodhur në orët e para të 11 marsit. Për viktimat është raportuar për qytezën Vidnoje dhe fshatin Jam, afër qytezës Domodedovo. Ministria ruse e Mbrojtjes ka thënë se 337 dronë të nisur nga

Ukraina janë rrëzuar. Ende nuk dihet saktë se sa dronë janë përfshirë në këtë sulm, më të madhin në territorin rus në javët e fundit. Ky sulm ka ndodhur teksa zyrtarë të lartë amerikanë dhe ukrainas po përgatiten që të takohen në Arabinë Saudite për të diskutuar se si t'i jepet fund luftës në Ukrainë. Në ditët e fundit Rusia i ka shtuar sulmet në infrastrukturën ukrainase dhe shënjestra civile, teksa diplomacia rreth luftës është shtuar. Në disa fotografi dhe video të paverifikuara nga Moska dhe rrethina, është parë momenti i kryerjes së sulmeve me dronë

në ndërtesa të banimit. Ukraina nuk e ka marrë përgjegjësinë për sulmin. Sulmi ka ndikuar edhe në punën e disa aeroporteve. Agjencia Federale e Rusesë për Transport Ajror ka raportuar se aeroportet Zhukovski dhe Domodedovo e kanë pezulluar përkohësisht punën për shkak të sulmeve. Ndërkohë edhe aeroporti i Vnukovos nuk ka pranuar aeroplanë në ardhje. Situata vazhdon të jetë e tensionuar teksa autoritetet vlerësojnë shkallën e dëmit nga sulmet dhe vazhdojnë ta monitorojnë situatën për mundësinë e kërcënimeve potenciale.



Ndërkohë, forcat ukrainase për mbrojtje ajrore kanë thënë më 11 mars se kanë rrëzuar një raketë balistike ruse, Iskander-M dhe 79 dronë përgjatë natës.

Dronët është raportuar të jenë rrëzuar në disa rajone, përfshirë Kievin, Odesan, Dnjipropetrovskun dhe Harkivin.

Sulmet izraelite vrasin palestinezë në Gazë dhe Bregun Perëndimor

GAZA, 11 MARS - Sulmet izraelite kanë vrarë tetë persona në Rripin e Gazës në 24 orët e fundit, thanë zyrtarët palestinezë, teksa armëpushimi i brishtë me Hamasin - grupin palestinez të shpallur organizatë terroriste nga Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian - gjerësisht është ende në fuqi. Ndërkaq, në Bregun e pushtuar Perëndimor raportohet se janë



vrarë tre palestinezë. Sulmet ajrore izraelite vranë disa palestinezë që, sipas

ushtresë izraelite, po iu afroreshin trupave apo hynë në zona të paautorizuara në shkelje të armëpushimit të arritur në janar. Javën e kaluar Izraeli ka pezulluar furnizimet me mallra dhe energji elektrike për territorin ku jetojnë më shumë se 2 milionë palestinezë, teksa po synon t'i bëjë presion Hamasit që ta pranojë zgjatjen e fazës së parë të

armëpushimit. Faza e parë përfundoi më 1 mars. Izraeli dëshiron që Hamasi ta lirojë gjysmën e pengjeve të mbetura në këmbim të premtimit për të negociuar një armëpushim afatgjatë. Hamasi ka thënë se dëshiron nisjen e negociatave për fazën e dytë të armëpushimit, kur është paraparë që të lirohen pengjet e mbetura në Gazë,

tërheqja e trupave izraelite dhe një paqe e qëndrueshme. Hamasi besohet se ende ka 24 pengje që janë gjallë dhe trupat e 35 të tjerëve. Hamasi e nisi luftën në Gazë, pasi sulmoi Izraelin më 7 tetor 2023, duke vrarë 1 200 persona dhe duke rrëmbyer 250 të tjerë. Që atëherë, si pasojë e ofensivës ushtarake të Izraelit, në Gazë janë vrarë më shumë se 48 000 palestinezë.

Vuçiqi takon djalin e Trumpit në Beograd

BEOGRAD, 11 MARS - Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, ka thënë të martën se ka zhvilluar një bisedë të përzemërt me Donald Trump Jr., djalin e presidentit amerikan Donald Trump, lidhur me marrëdhëniet dypalëshe midis Serbisë dhe Shteteve të Bashkuara, dhe për temat aktuale me rëndësi politike dhe ekonomike në botë. “Theksova rëndësinë e marrëdhënieve ekonomike dhe politike ndërmjet Serbisë

dhe Shteteve të Bashkuara dhe theksova rëndësinë e bashkëpunimit strategjik mes dy vendeve dhe projekteve të përbashkëta në vitet e ardhshme. Ky takim simbolizon angazhimin për forcimin e marrëdhënieve dypalëshe dhe punën së bashku për të adresuar sfidat globale”, ka thënë Vuçiqi në “Facebook”. Trump Jr. ka qenë në Beograd në shtator të vitit 2024, kur ka diskutuar me një grup

biznesmenësh nga Serbia për investimet potenciale. Dhëndri i Trumpit, Jared Kushner, veçse ka nisur të bëjë biznes në Beograd. Me kompaninë e tij është nënshkruar një kontratë në maj të vitit 2024 për të ndërtuar një kompleks afarist dhe rezidencial të një ish-shefi të Shtabit të Përgjithshëm, pjesë të të cilit janë shkatërruar si pasojë e intervenimit të NATO-s më 1999.



Rinumërohen 13 nga 50 vendvotime që i takojnë komunës së Vushtrrisë, procesi vazhdon

PRISHTINË, 11 MARS - Në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve është duke vazhduar rinumërimi i vendvotimeve sipas vendimit të KQZ-së, i datës 10 mars 2025. Sipas të dhënave, deri në përfundim të ditës së hënë janë rinumëruar 13 vendvotime nga 50 sa është numri i përgjithshëm i tyre për të cilat ka marrë vendim KQZ-ja. Vendvotimet e rinumëruara deri më tani i takojnë komunës së Vushtrrisë. Gjatë ditës së martë do të procedohet rinumërimi edhe i vendvotimeve të tjera. Në mbledhjen e mbajtur më 10 mars, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mori dy vendime për rinumërimin e 50 vendvotimeve. Procesi i rinumërimit po zhvillohet në prani të vëzhguesve të akredituar.



ABDIXHIKU: LDK-ja NUK ËSHTË PJESË E ÇFARËDO ZGJIDHJE KU NUK UDHËHEQ QEVERINË

EPOKA ERE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 11 MARS - Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lumir Abdixhiku, ka mbajtur mbledhje të Kryesisë, në të cilën ka diskutuar për procesin zgjedhor të 9 shkurtit. Sipas njoftimit të LDK-së, gjatë mbledhjes u diskutua rreth rezultatit zgjedhor të LDK-së, performancës nëpër degë të Kosovës, performancës së degëve në mërgatë si dhe pozicionit politik të LDK-së pas rezultatit final. “Ashtu siç dhe e theksoi kryetari Abdixhiku në konferencën pas këtij takimi të gjatë, Kryesia ka vlerësuar pozitiv dhe në rritje rezultatin e Lidhjes Demokratike pas procesit zgjedhor, si rezultat të mbarë dhe stabil për vetë partinë, ndërsa LDK do të angazhohet maksimalisht që kjo trajektore e rritjes të vazhdojë”, thuhet në njoftimin e LDK-së. Kryetari Abdixhiku, po ashtu, theksoi se nuk ka pasuar asnjë

takim me partinë në pushtet dhe asnjë parti tjetër. “LDK mesazhin dhe pozicionin e saj e ka të qartë, dhe ashtu siç ka thënë edhe më herët që nuk bashkëpunon me partinë në pushtet; po ashtu në asnjë rrethanë nuk është pjesë e çfarëdo zgjidhje ku nuk udhëheqë me Qeverinë. Ndërsa Kryesia gjithashtu ka vendosur që LDK-ja nuk synon të punoj ëpër një qeveri afatshkurtër, pasi që e vlerëson se një gjë e tillë nuk sjell stabilitet qeveritar”, theksohet në njoftimin e LDK-së. Më tutje thuhet se Lidhja Demokratike e Kosovës tani është e fokusuar të rikthehet në angazhimin e saj drejt zgjedhjeve lokale, më e fuqishme dhe drejt synimit të saj për rritjen e rezultatit elektoral. “Me një punë të madhe, LDK është e vendosur të fitojë besimin e qytetarëve dhe të rrisë numrin e komunave nën udhëheqjen e saj”, ka njoftuar LDK-ja. Lëvizja Vetëvendosje është fituese e zgjedhjeve të 9 shkurtit me 42.27 për qind të



votave të fituara apo 48 ulëse në Kuvendin me 120 vende. Kjo nënkupton se kjo parti nuk mund ta formojë e vetme ekzekutivin e ri, për të cilin duhen 61 deputetë. LDK-ja mori rreth 17 për qind të votave në zgjedhjet e 9 shkurtit, një ngritje prej rreth 5 për qind në krahasim me zgjedhjet e mëparshme parlamentare të vitit 2021. Sipas parashikimeve, LDK-së do t'i takojnë 20 ulëse në Kuvendin e ardhshëm.

ILIR META, KANDIDAT PËR DEPUTET NË LISTËN E HAPUR TË QARKUT TIRANË



TIRANË, 11 MARS - Kryetari i Partisë së Lirisë, Ilir Meta, nga qelia e burgut ka falënderuar kryesinë e partisë që edhe pse në kushte ekstreme izolimi, do të jetë kandidat për deputet në listën e hapur të Qarkut Tiranë. “Unë nuk krijova parti për t’u bërë deputet por për të garantuar rotacionin politik dhe për të zhbllokuar integrimin evropian të vendit. Edhe sot, për të gjithë ata që i kanë sytë në ballë dhe e panë rrëmbimin tim kriminal dhe që e dinë se ku ndodhem, u them se pavarësisht se jam në kushte ekstreme izolimi është detyra ime të udhëheq Partinë e Lirisë me shembullin tim dhe të luftoj me të gjithë fuqitë e mia për t’u

treguar të gjithëve se kjo është një betejë që në radhë të parë kërkon sakrifica ekstreme për t’u fituar dhe jo llogari meskine afatshkurtra nga ata që mendojnë se politika është narativë apo perceptim. Ilir Meta me shembullin e tij nga qelia Nr. 5 tregon se lufton për kauza të mëdha dhe se nuk i tradhton kauzat që beson. Mafia nuk luftohet duke vegjetuar apo duke pritur dhurata nga qielli”, ka shkruar ai në “Facebook”. Ai i ka falënderuar të gjithë për mirëkuptimin dhe për mbështetjen në këtë betejë historike për fitoren e koalicionit “PD-Aleanca për Shqipërinë Madhështore”.

Instituti GAP: Në vitin 2024 eksportet e shërbimeve të teknologjisë arritën në 347.4 milionë euro

PRISHTINË, 11 MARS - Në vitin 2024 eksportet e shërbimeve të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) nga Kosova arritën në 347.4 milionë euro, me një rritje prej 21 % (+61.4 milionë euro) krahasuar me vitin 2023. Kështu ka njoftuar Instituti GAP, i cili ka publikuar një grafikë me disa të dhëna që nga viti 2021. GAP-i ka bërë me dije se dinamika e rritjes së eksporteve të TIK-ut nga Kosova është tejet mbresëlënëse, me pothuajse pesëfishim të vlerës së eksporteve në vetëm katër vjet.





SEKRETARI I PËRGJITHSHËM I NATO-S, MARK RUTTE, KA QËNDRUAR TË MARTËN PËR VIZITË NË KOSOVË

SEKRETARI I NATO-s THOTË SE PËRPARIMI NË DIALOGUN KOSOVË - SERBI KËRKON FLEKSIBILITET DHE KOMPROMISE

Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Mark Rutte, ka thënë të martën në Prishtinë se dialogu në mes të Kosovës dhe Serbisë është e vetmja mënyrë për t'i zgjidhur çështjet e hapura, duke shtuar se kërkohet fleksibilitet dhe kompromis. Në konferencën e përbashkët për medie me presidenten Vjosa Osmani në Prishtinë, Rutte ka deklaruar se stabiliteti në rajonin e Ballkanit Perëndimor varet nga të gjitha palët, duke zgjedhur “diplomacinë në vend të dhunës”. Rutte u shpreh se prania e tij në Kosovë është demonstrim i qartë i përkushtimit të palëkundur të NATO-s për siguri afatgjatë në gjithë Kosovën, pastaj edhe për stabilitetin e rajonit

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 11 MARS - Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Mark Rutte, ka thënë të martën në Prishtinë se dialogu në mes të Kosovës dhe Serbisë është e vetmja mënyrë për t'i zgjidhur çështjet e hapura, duke shtuar se kërkohet fleksibilitet dhe kompromis. “Për ta lëvizur këtë dialog përpara, të dyja palët duhet të tregojnë fleksibilitet dhe t'i bëjnë kompromiset e nevojshme dhe të përqendrohen në përfitimet afatgjatë”, tha ai. Sipas tij, normalizimi sjell më shumë stabilitet dhe siguri për mbarë rajonin. Në konferencën e përbashkët për medie me presidenten

Vjosa Osmani në Prishtinë, Rutte ka deklaruar se stabiliteti në rajonin e Ballkanit Perëndimor varet nga të gjitha palët, duke zgjedhur “diplomacinë në vend të dhunës”. “Stabiliteti në rajon varet nga të gjitha palët që ta zgjedhin diplomacinë para dhunës. Zgjidhja për një paqe afatgjatë është politike, dhe në këtë drejtim NATO-ja do të vazhdojë ta mbështesë normalizimin e marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë të udhëhequr nga BE-ja. Për ta shtyrë përpara këtë dialog të dyja palët duhet të shfaqin fleksibilitet dhe t'i bëjnë kompromiset e duhura dhe të fokusohen në dobritë afatgjatë”, ka thënë Rutte.

Sekretari i NATO-s u shpreh se

për të arritur këtë duhen vendime të vështira. “E kuptoj që kjo kërkon vendime të vështira, por normalizimi sjell stabilitet më të madh. Ky është mesazhi që unë do të vazhdoj ta theksoj para të gjitha palëve në Ballkan”, ka thënë Rutte. Rutte u shpreh se prania e tij sot në Kosovë është demonstrim i qartë i përkushtimit të palëkundur të NATO-s për siguri afatgjatë në gjithë Kosovën dhe pastaj edhe për stabilitetin e rajonit. “NATO-ja ka mbështetur paqen, stabilitetin në Ballkanin Perëndimor për tashmë 30 vjet me radhë. Përkushtimi ynë mbetet i qëndrueshëm edhe sot i udhëhequr nga KFOR-i që është misioni më afatgjatë dhe më i madh. Trupat tanë të

KFOR-it punojnë pa pushim për të siguruar një ambient të qetë dhe të sigurt për të gjitha komunitetet që jetojnë në Kosovë”, u shpreh Rutte gjatë konferencës për medie në Prishtinë.

Sekretari i përgjithshëm i NATO-s më tej shtoi se “një rajon më i sigurt i Ballkanit Perëndimor, nënkupton më shumë siguri për gjithë zonën e NATO-s”. “Duhet ta kemi të qartë çfarë kemi para nesh. Jemi plotësisht të gatshëm t'i përgjigjemi çfarëdo lloj zhvillimi të sigurisë dhe për këtë shpresojmë të shohim një bashkëpunim edhe më të thellë mes institucioneve të Kosovës dhe KFOR-it në këtë drejtim. NATO-ja do të vazhdojë ta luajë rolin e vet në mandatin e vet për sigurinë e të gjithëve në bashkëpunim me Policinë e Kosovës dhe EULEX-in”, ka deklaruar Rutte.

Ai falënderoi presidenten Vjosa Osmani për mikpritjen dhe fjalët e ngrohta. Ndërkaq presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, tha se mbështet deklaraten e bërë një ditë më herët në Bosnjë nga Rutte se në rajon nuk duhet të ketë vakuume të sigurisë sepse, sipas saj, “historia ka dëshmuar se ato vakuume

shpesh janë keqpërdorur nga faktorët malinj”.

Osmani, po ashtu, foli edhe për Serbinë, të cilën e akuzoi se po minon “përpjekjet për paqe dhe stabilitet”. Me ndihmën e Rusisë dhe faktorëve të tjerë, presidentja tha se Beogradi po synon ta destabilizojë Kosovën. Në këtë drejtim ajo përmendi sulmet e ndodhura vitet e fundit në veriun e banuar me shumicë serbe prandaj, sipas Osmanit, është e rëndësishme prania e NATO-s në Kosovë si “barrierë kundër çfarëdo përpjekje për cenimin e paqes”. “Prania e trupave të NATO-s në Kosovë nuk është garanci vetëm për sigurinë tonë kundër çfarëdo përpjekje për cenimin e paqes dhe stabilitetit për të cilët të gjithë së bashku kemi punuar dhe sakrifikuar shumë gjatë”, ka thënë Osmani. Sipas saj, mungesa e përgjegjësisë për këto sulme, për të cilën Osmani fajësoi Serbinë, ka inkurajuar Beogradin “t'i vazhdojë sulme nëpërmjet strukturave të tij paramilitare”. “Prandaj është e rëndësishme që bashkërisht ta fuqizojmë praninë edhe të personelit edhe të mjeteve për ta mbrojtur kufirin në mënyrë që të parandalohet si hyrja e

GAZETA BRITANIKE: SHQIPËRIA, NDËR VENDET MË TË MIRA PËR TË UDHËTUAR NË VITIN 2025

TIRANË, 11 MARS - Riviera shqiptare është ndër vendet më të pëlqyera nga turistët anekënd botës. Vitet e fundit ka pasur zhvillim të madh të turizmit në Shqipëri, që nuk ka kaluar pa u vënë re. Madje bregdeti shqiptar u pagëzua edhe me emrin “Maldivet e Evropës”. Shumë artikuj iu kushtuan “perlës shqiptare”. Një shkrim iu kushtua edhe nga gazeta britanike, “Metro”. Autorja e këtij shkrimi Sophie-May Williams e përshkruan në detaje për mrekullitë që ofron. Vitet e fundit Shqipëria është kurorëzuar me statusin e ‘Perlë e fshehur’. Riviera mahnitëse shqiptare është pagëzuar gjithashtu me emrin “Maldivet e Evropës”, gjithashtu falë çmimeve mbresëlënëse.

Ndërsa vendi ballkanik po përjeton kohët e fundit një rritje të turizmit, fluturimet dhe akomodimet janë të lira. “Fluturoni në Tiranë dhe shkoni në jug të vendit për disa pamje të mahnitshme. Vendet si plazhi i Dhërmiut mund të jenë të populluar, por janë të bukur, duke ofruar pamje nga deti dhe një sfond magjepsës të Maleve të Vetëtimës. Ose mund të udhëtoni drejt Durrësit, në veri të Tiranës, për më shumë vende bregdetare. Megjithatë, zhvillimi i Shqipërisë nga një vend i izoluar në një destinacion kryesor për pushime nuk është arritur pa sfidat e saj. Gazetarja e medias britanike “Metro”, Alice Murphy e vizitoi vendin vitin e kaluar dhe vuri

në dukje se bumi i turizmit ishte një “thikë me dy presa”. Ndërsa turistët e huaj janë joshur nga videot virale të ujërave bruz dhe rërës së bardhë dhe të pacenuar - kush nuk do të ishte? - rritja e fluksit turistik ka prodhuar një sërë ndërtimesh që mund ta kërcënojnë peizazhin spektakolar. Megjithatë, ekspertët e udhëtimeve thonë se koha më e mirë për ta vizituar Shqipërinë është fundi i pranverës, prill-maj dhe fillimi i vjeshtës, shtator-tetor. Në këtë mënyrë ju mund t'i shmangni turmat e vizitorëve dhe të kontribuoni drejt një qasjeje më të qëndrueshme turistike. Ju rekomandojmë të merrni me qira një makinë për të



përfitur sa më shumë nga pushimet tuaja në Shqipëri. Çmimet fillojnë nga 6-7 paund në ditë.

Përballueshmëria e Shqipërisë do të thotë se akomodimi nga një bujtinë në një hotel është padyshim një opsion.



grupeve terroriste, ashtu edhe e armatimit të tyre të cilët kanë për qëllim krijimin e konflikteve në rajonin tonë.

Ashtu siç e ka thënë presidenti amerikan Donald Trump, politika e paqes përmes fuqisë është ajo që do të kuptohet më

së miri në këtë rajon, e sidomos nga ata të cilëve mund t'u shkojë mendja që të përdorin veprime



destabilizuese”, është shprehur Osmani. Sekretari i NATO-s është takuar edhe me kryeministrin Albin Kurti. Vizita e Ruttesit në Kosovë zhvillohet pas asaj që ai bëri në Bosnjë-Hercegovinë më 10 mars, ku dha mesazhin që aleanca nuk do të lejojë që “të rrezikohet paqja e fituar me shumë vështirësi”. Rutte gjatë vizitës në Sarajevë u zotua për mbështetjen “e palëkundur” të tërësisë tokësore të Bosnjës, ndërsa bëri thirrje kundër çdo veprimi që nxit tensione në vendin ballkanik. Bosnjë-Hercegovina mund të mbështetet në përkrahjen e NATO-s, e cila nuk do të lejojë

që paqja e fituar me vështirësi të rrezikohet, tha sekretari Rutte. “Çdo veprim që dëmton Dejtonin, rendin kushtetues apo institucionet kombëtare është i papranueshëm. Retorika dhe veprimet nxitëse janë të rrezikshme. Ato paraqesin një kërcënim të drejtpërdrejtë për qëndrueshmërinë dhe sigurinë e Bosnjë-Hercegovinës”, ka thënë Rutte. Sekretari i NATO-s qëndroi në Bosnjë në një periudhë tensionesh pasi ligjvënësit e entitetit serb miratuan një sërë ligjesh që u ndalojnë autoriteteve gjyqësore qendrore dhe policisë, të veprojnë në territorin e Republikës Serbe.



Sa trupa i ka NATO-ja në Kosovë?

Gjithsej 4 686 trupa nga 29 vende të botës shërbejnë aktualisht në Kosovë në kuadër të misionit paqeruajtës të Organizatës së Traktatit të Atlantikut Verior (NATO), KFOR. Më shumë se gjysma e forcave janë nga Italia, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Hungaria dhe Turqia. NATO-ja e ka shtuar praninë e saj në Kosovë gjatë vitit 2023, pas rritjes së tensioneve në veriun e banuar me shumicë serbe.

Kosova me mungesë serioze të kapaciteteve institucionale në menaxhimin e rreziqeve klimatike

PRISHTINË, 11 MARS - Instituti për Siguri dhe Reziliencë "Prevent" ka lansuar raportin hulumtues mbi kapacitetet institucionale të sigurisë për përballimin e emergjencave civile, katastrofave natyrore dhe sfidave të tjera të shkaktuara nga ndryshimet klimatike. Aty u tha se Kosova përballet me mungesë serioze të kapaciteteve institucionale në menaxhimin e rreziqeve klimatike, sidomos në përgjigjen emergjente, koordinimin mes institucioneve qendrore dhe lokale si dhe në burimet financiare dhe teknike. Kosova ishte shumë e cenueshme ndaj përmbytjeve të shpeshta, thatësirave të zgjatura, krizës së ujit, zjarreve

në pyje dhe temperaturave ekstreme të cilat kërcënojnë sigurinë ushqimore, shëndetin publik dhe stabilitetin ekonomik. Adea Kondirolli tha se ky raport po vjen në kohën më kritike me të cilën po përballet Kosova, si thatësira e vërshimet e shpeshta. "Ndryshimet nuk janë diçka që mundemi me u përballë individualisht, por duhet organizim ndërinstitucional dhe kështu OJQ-të ndërkombëtare janë duke punuar në drejtim të energjisë së gjelbër. Kosova aktualisht ka sfida të shumta dhe ky raport vjen pikërisht në këtë kohë me të cilën po përballet Kosova", tha ajo. Andi Batusha, bashkautor i këtij raporti, tha se ndryshimet



klimatike nuk janë thjesht një çështje mjedisore, por ato përbëjnë një sfidë për sigurinë, ekonominë dhe shoqërinë. "Kosova përballet me rreziqe në rritje si: temperatura ekstreme, përmbytja, thatësira dhe fatkeqësi natyrore.

Përgatitja institucionale është thelbësore, por kapacitetet aktuale janë të pamjaftueshme. Gjetjet kryesore janë si: sistemet e reagimit emergjent mungojnë, nuk ka burime dhe kapacitete teknike të mjaftueshme,

koordinim i dobët ndërinstitucional si dhe midis institucioneve të nivelit qendror dhe atyre lokale, kornizat strategjike dhe ligjore ekzistojnë, por mungojnë mekanizmat e zbatimit dhe monitorimit", tha Batusha. Ai përmendi edhe kërcënimet dhe rreziqet nga ndryshimet klimatike në Kosovë. "Rritje të temperaturave, valëve të të nxehtë, si rrjedhim i shtimit të periudhave me thatësi, shtim i vatrave dhe vëllimit të zjarreve: ndikim negativ në prodhim të ushqimit; ndërprerje e furnizimit me ujë. Gjatë vitit 2024 ka pasur mbi 100 raste të zjarreve në male, ku është kërkuar edhe kërkesë për intervenim nga ajri nga KFOR-i".

KOMANDANT NENADI!



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

Konferenca e së dielës: Albin Kurti që është KM i Kosovës duke pritur formimin e qeverisë Kurthi 3, të dielën e djeshme kur ishte ditë pushimi nga mospuna e ditëve tjera, papritmas paralajmëroi një konferencë për media bashkë me Nenad Rashiqin, ministër në qeverinë Kurthi 2. Nuk treguan pse mbahet kjo konferencë duke e mbështjellur me një vello të tejdukshme të "kurvërisë politike". Mendova se do ta bëjnë publike ndonjë koalicion bombastik për formimin e qeverisë "Kurthi 3". Albini po thotë se qeverinë e formon sigurisht dhe pa

Listën Serbe. Thashë se Nenad Rashiqi nga Zona Operative e LV-së në Livaxhë paska arritur të çnukë naj deputetë të LS-së, e sikur që Kurthi e çnuku një deputete në zgjedhjet e parafundit nga PDK-ja, duke e formuar qeverinë Kurthi 2 sikur që me ndihmën bujare të Listës Serbe e votuan Vojsa Osmanin - Sheriff-en për presidente. Miqësinë në Listën Serbe e vazhdoi besnikja e koalicionit, Limoza Kulari - el Gadaffi kundër veteranëve të luftës dhe UÇK-së. Po Albini në këtë mendermethënë konferencë bombastike, ndonëse e ka shtri sovranitetin cep me cep, tha se Serbia ka ndërhyrë në zgjedhjet e fundit dhe se: "vetëm i madhi ZOT në muajin e shenjtë të Ramazanit e paska shpëtuar Nenadin nga zemlaku i Mimosës, Radoiçiqi...". I tregoi 10 mënyra se se qenka kërcënuar Nenadi e që janë të papërfillshme me 23 goditje me thikë që ia bënë Brutus dhe Kasius, Imperatorit dhe Diktatorit Jul Cezari.

Interesant se para se u ther me thika, Jul Cezari i pati uzurpuar të gjitha postet dhe thirrjet si edhe nderet për veten. Kishte ndërhyrë edhe në kalendarin duke emërtuar muajin e shtatë Jul ndërkaq që kishte nxjerrë vendim të konsiderohej dhe festohej si Baba i Kombit. Shiheni tani lidhjen, Cezar Baba dhe Albini Baba. Ai diktator i përjetshëm, Albini në përpjekje të bëhet Diktator i mandaruar. Cezari kishte Gardën Pretoriane, Albini Gardën Pordhiane. Nenad Rashiqi u kundërshtua edhe nga pionieri politik i Vuçiqit dhe Vulinit, Arsenijeviq i cili KM Kurti e quajti robërues të popullit të tij kurse Rashiqin si ficus të Kurtit. Nuk e kam të qartë a ka menduar në lule apo... Lista Serbe tha se Rashiqi u bë ministër me votat e shqiptarëve në Prizren. Mund të ndodhë se i kanë vjedhur votat Driton Selmanajt se shumë ashpër po reagon. Ndryshe Nenad Rashiqi, bashkë me Atiqin e këtë dhunuesin e QNR-së, Alimin

janë tre musketierët e LV-së që do ta çojnë bashkimin kombëtar deri sa të bashkohen... me Serbinë, konfederatë a federatë, Marrëveshja e Brukselit dhe Ohrit e garantojnë këtë. Kurti e thotë se e bënë qeverinë sigurt, pra LV dhe ai KM. Edhe unë besoj. Votat e Listës Serbe janë përcaktuese, nëse Beogradi pajtohet. Midis asaj se a rri në opozitë apo e formon qeverinë me LS-në nuk kam dilemë, Kurti nuk e dorëzon pushtetin, vetëm nëse detyrohet. Tash, pa LS-në nuk i ka votat përkundër besnikërisë, deri në vdekje politike të Emilly "Bronte" Rexhepi. Ajo tha se nuk e tradhton Kurtin shkaku se e paska bërë z/kryeministre. Çfarë injorante dhe e pacipë. Kurti nuk do të qeverisë me LDK-në dhe PDK-në sepse nuk do të mund të bënte ç' të dojë si me këta ministra, injorantë dhe antikombëtarë që i ka. Kurti do që të sundojë e jo të qeverisë. Me Komandant Nenadin lehtë e bënë sikurse me atë shërbëtoren Emilly Bronte. Opozita nuk duhet ta pengojë

Kurthin ta bëjë qeverinë por nuk duhet t'i bashkohet në asnjë mënyrë. As edhe një deputet i vetëm. Deri më tani opozita ka qëndrim korrekt, në përputhje me mandatin opozitar.

Të rinumërohen votat: LV-ja e ka të drejtë kur kërkon rinumërimin e votave, e ka përkrahjen time. E përkrah propozimin që të anulohen këto zgjedhje dhe të shpallen zgjedhjet e reja në afatin 45 ditor. Për arsye logjistike dhe ruajtjes së votës së LV-së propozoj të mos ketë votime me postë për diasporën. Të gjitha votimet duhet të bëhen në ambasada dhe konsulata sikurse edhe në rezidencën e Martin Gen Strujës dhe Donika Zezës. Vetëm në këtë mënyrë ruhet vota. Për votime në Kosovë duhet të hapen disa ambasada dhe konsulata për aq kohë sa të votohet dhe pas numërimit duhet të mbyllen. Nuk duhet të pranohet asnjë rezultat ku LV-ja del më pak se 82 për qind. Të poshtër dhe hajna.

Supremja lë në fuqi dënimin ndaj Shaban Gogajt për vrasje nga pakujdesia

PRISHTINË, 11 MARS - Gjykata Supreme, me vendimin e 27 shkurtit 2025, ka refuzuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të parashtruar nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, duke lënë në fuqi vendimin e Gjykatës Themelore në Pejë - Departamenti për Krime të Rënda ..., të datës 15.03.2024 dhe aktgjykimin të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda, ... të datës 03.10.2024", thuhet në vendimin e Supremes, raporton "Betimi për Drejtësi".

"Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit të Kosovës, e paraqitur kundër aktgjykimin të Gjykatës Themelore në Pejë - Departamenti për Krime të Rënda ..., të datës 15.03.2024 dhe aktgjykimin të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda, ... të datës 03.10.2024", thuhet në vendimin e Supremes, raporton "Betimi për Drejtësi".

Ky medium kishte raportuar se Gjykata e Apelit dënimin me burgim nga 7 vjet e 6 muaj sa e kishte dënuar Gogajn shkalla e parë, e kishte ulur në 6 vjet e 6 muaj burgim. Kundër vendimeve të Themelores dhe Apelit, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka parashtruar Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit për shkelje esenciale e shkelje të Ligjit Penal, me propozim që Supremja t'i anulojë vendimet paraprake. Mbrojtësi i të akuzuarit,



Gogaj, avokati Besnik Berisha, në mendimin e tij kishte kërkuar që Supremja ta hedhë si të palejuar apo ta

refuzojë kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit.

ATK-ja bën thirrje të deklarohen të ardhurat dhe të paguhen tatimet

PRISHTINË, 11 MARS - Administrata Tatimore e Kosovës ua ka rikujtuar të gjithë personave fizikë joafaristë, personave fizikë afaristë dhe personave juridikë, se janë të detyruar t'i deklarojnë dhe t'i paguajnë tatimet dhe kontributet pensionale, në mënyrë reale dhe në kohë, ashtu siç është përcaktuar me legjislacionin tatimor. “Aktivitetet e ATK-së, në vazhdimësi, do të përqendrohen pikërisht te personat, të cilët nuk i deklarojnë të ardhurat e realizuara dhe nuk paguajnë

tatimet dhe kontributet pensionale. Për personat fizikë jo afaristë, personat fizikë afaristë dhe personat juridikë, të cilët nuk deklarojnë të ardhurat e realizuara dhe nuk paguajnë tatimet dhe kontributet pensionale, ATK-ja do të ndërmarrë masat ndëshkuese sipas legjislacionit tatimor. Andaj, ATK-ja u bënë thirrje të gjithë personave që të deklarojnë të ardhurat e realizuara apo të korrigjojnë sa më parë deklaratat e tyre dhe të përmbushin të gjitha detyrimet tatimore të parapara me legjislacionin tatimor”, ka

njoftuar ATK-ja. Sipas ATK-së, me kryerjen e detyrimeve tatimore kontribuoni direkt në financimin e programeve qeveritare siç janë: ofrimi i shërbimeve publike, arsimim me standarde të larta, mirëqenie shëndetësore dhe sociale, mbrojtje ligjore dhe siguri, si dhe infrastrukturë të përgjithshme për një mirëqenie më të mirë ekonomike dhe shoqërore. “Pagesa e tatimit siguron qëndrueshmëri të ekonomisë në vend!”, theksohet në njoftimin e ATK-së.



Kosova përkujton 44-vjetorin e demonstratave të vitit 1981

EPOKA ERE **Faton DËRMAKU**
PRISHTINË, 11 MARS - 44 vjet më parë nga Prishtina filloi një seri goditjesh tronditëse për Serbinë dhe tërë Jugosllavinë, kur më 11 mars 1981 studentët e Universitetit të Prishtinës u ngritën në një demonstratë masive, vetëm një javë pasi ishin revoltuar në mensën e studentëve më 4 mars. Kryeministri Albin Kurti ka thënë se studentët protestonin kundër shtypjes dhe diskriminimit, mohimit e kufizimit të të drejtave, si dhe kundër shfrytëzimit dhe pabarazive që shteti i Jugosllavisë po ua bënte shqiptarëve në tërë federatën jugosllave, veçanërisht në Kosovë. “Demonstrata e asaj të mërkure, e datës 11 mars 1981, u shtyp dhunshëm nga policia jugosllave, por fryma e indinjatës dhe e rebelimit të studentëve u kthye në inspirim për një rezistencë gjithëpopullore. Të tjera

demonstrata u organizuan edhe më 26 mars, pastaj më 1 dhe 2 prill, që protestat studentore i kthyen në demonstrata gjithëpopullore. Ato u shtypën me dhunë nga policia, kurse në muajt dhe vitet pasuese, autoritetet jugosllave bënë mijëra arrestime arbitrare, gjyqe dhe burgosje politike, duke e bërë Kosovën vendin me numrin më të madh të burgosurve politikë për kokë banori në gjithë Evropën”, ka shkruar Kurti në “Facebook”. Ai ka shtuar se në demonstratat e vitit 1981 u shfaq parulla “Kosova Republikë”, e cila vazhdoi të shkruhej gjatë tërë asaj dekade, herë e plotë e herë si një akronim me dy shkronja “KR”. Kurti ka thënë se shumë organizata politike ilegale fituan forcë nga demonstratat e vitit 1981 dhe nga trashëgimia e tyre, duke e mbajtur të gjallë shpirtin e revoltës popullore dhe të



rezistencës për një Kosovë të lirë. “Brezi i demonstruesve dhe aktivistëve të vitit 1981, ishin shtyllë e grupeve themeltare të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, që me luftën e drejtë në dekadën pasuese, e çliruan Kosovën në qershor të vitit 1999. Kështu, parulla popullore “Kosova Republikë”, u bë Deklaratë Kushtetuese më 2 korrik 1990

dhe Kushtetutë e Kaçanikut më 7 shtator 1990 drejt realitetit politik të shpallur më 17 shkurt 2008, në formacionin politik e juridik të Republikës së Kosovës si shtet i pavarur”, ka thënë Kurti. Ndërkaq Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ka theksuar se më 11 mars 1981 studentët dhe qytetarët e Kosovës ndezën flakadanin e lirisë dhe

dinjitetit kombëtar. “Sot përulemi me respekt para guximit dhe vizionit të tyre, qëndresës së pathyeshme që ndriçoi rrugën tonë drejt shtetësisë. Kujtimi dhe vepra e tyre do të frymëzojnë gjithmonë brezat që vijnë!”, është thënë në njoftimin e PDK-së. Kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka thënë se demonstratat e 11 marsit 1981 shënojnë një epokë vendimtare në historinë më të re të Kosovës. “Mijëra studentë, me guximin dhe vizionin e tyre dhanë mesazhin e qartë se shqiptarët nuk i nënshtrohen regjimit dhe se liria është e panegociueshme. Rinia heroike shqiptare, e frymëzuar nga guximi dhe vendosmëria e protestuesve të vitit 1981, vazhdoi rrugën e qëndresës deri në betejat e lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Me gjakun dhe sakrificën e saj, ajo e bëri realitet ëndrrën e lirisë që e gëzojmë sot”, ka shkruar Haradinaj në “Facebook”. Edhe lideri i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka thënë se demonstratat e 11 marsit të vitit 1981 dhe demonstratat e mëvonshme të atij viti shënuan kthesën e madhe në përpjekjet e popullit tonë për liri e pavarësi. “Në këtë ditë të rëndësishme, ne kujtojmë dhe nderojmë me sinqeritetin më të madh të gjithë ata protestues, të cilët me vendosmëri dhe guxim të lartë artikuluan të drejtën e qytetarëve të Kosovës për Republikë”, ka thënë Limaj.



Pas grevës në aeroporte, fluturimet nga Prishtina për në Gjermani po realizohen sipas planit

PRISHTINË, 11 MARS - Greva njëditore që përfshiu 13 aeroporte gjermane të hënën, bëri që disa fluturime nga Prishtina për në Gjermani të anulohen. Mirëpo ky problem është zgjidhur dhe të martën nuk ka

pasur ndonjë anulim të fluturimeve për në Gjermani. Kështu ka bërë me dije për “Telegraf”-in, zëdhënësja e Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës, Valentina Gara. “Nuk ka anulime, të gjitha fluturimet janë

duke u realizuar sipas planit”, ka thënë Gara. Një ditë më parë Policia Kufitare e Aeroportit të Prishtinës i informoi pasagjerët se për shkak të grevës së përgjithshme të punonjësve të operimeve në aeroportet e

Gjermanisë, pritet që të kishte anulime të fluturimeve për në aeroportet gjermane. Anulimet ishin përkatësisht atje ku ka linja direkte nga Aeroporti Ndërkombëtar “Adem Jashari”.



Dinari serb, i ndaluar në rregullore, i pranuar në treg



Tash e një vit Kosova e nxori jashtë ligjit dinarin serb, por në veri të vendit paraja e gjen rrugën. Bankat e refuzojnë, por dyqanet dhe shitësit ende e pranojnë, disa më hapur, të tjerët më në hije. Për shumë qytetarë ndalesa nuk i ka ndaluar transaksionet, thjesht i ka bërë më të komplikuar

PRISHTINË, 11 MARS - Miki, një shitës ambulant i pemëve dhe perimeve, ka të ngritur standën e tij në qendër të Mitrovicës së Veriut - njërën prej katër komunave të banuara me shumicë serbe në veri të Kosovës. Shitjen e produkteve thotë se e bën në çdo valutë të mundshme. “Çfarëdo që të më japin... të gjitha shkojnë - dollari, franga, euroja, por edhe dinari. Nuk ka problem. Në treg nuk është i ndaluar. Nëpër shitore, nuk e di... Nuk e ka ndaluar askush deri më tash. Mbase, në banka po”, thotë Miki për Radion Evropa e Lirë. Bankat në Kosovë - përfshirë veriun e vendit - nuk bëjnë transaksione financiare me dinarë të Serbisë. Rregullorja e Bankës Qendrore të Kosovës, e cila i ndalon pagesat me valuta të tjera pos euros, hyri në fuqi më 1 shkurt, 2024, ndërsa perioda transitore për zbatimin e saj përfundoi më 13 maj të atij viti. Institucionet financiare të Serbisë në veri, ndërkohë, u mbyllën, ndërsa u hapën degë të bankave të Kosovës. Kjo i dha fund praktikës gati 25-vjeçare të përdorimit të dinarit në atë zonë. Miki thotë se dinarët që i mbledh nga shitja, i tubon dhe me to shkon në Rashkë - qytet kufitar në Serbi - për t'i konvertuar në euro. “Deri në 10 mijë euro mund t'i bart përtej kufirit pa probleme [ligjore]. Por, unë nuk arrij t'i bëj 10 mijë euro qarkullim as për dy muaj”, thotë ai. Në vitrinat e disa shitoreve në Mitrovicë të Veriut, të cilat i vizitoi ekipi i REL-it javën e parë të marsit, figurojnë ende çmime me dinarë.

Megjithatë, në një dyqan me produkte të konsumit të përditshëm, në afërsi të sheshit “Mbreti Llazar”, pronari thotë se pagesat me dinarë janë të ndaluara. Edhe çmimet në atë biznes ishin me euro. “Kush jep dinar, ne ua shndërrojmë [sipas çmimit në euro] dhe më pas i blejmë eurot”, thotë pronari, pa dashur të identifikohet. Ai shton se “ka pranuar rrezikun që pagesat t'i pranojë edhe me dinarë, për shkak se nuk do që t'i largohen klientët”. Shumë nga klientët e tij, por edhe banorë të tjerë të zonës, në pamundësi që në bankat e Kosovës të marrin paga, pensione apo përfitime të tjera nga buxheti i Serbisë, shkojnë në Rashkë. Në atë qytet, autoritetet serbe kanë vendosur bankomatë dhe kanë hapur pika postare, ku qytetarët serbë mund t'i tërheqin përfitimet e tyre në dinarë. Përveç institucioneve financiare, autoritetet e Kosovës kanë mbyllur edhe të tjera që kanë funksionuar brenda sistemit të Serbisë në Kosovë, por disa - si ato në shëndetësi e arsim - vazhdojnë punën. Radio Evropa e Lirë pyeti Administratën Tatimore të Kosovës se a ka bërë dhe a vazhdon të bëjë inspektime në dyqanet në veri të Kosovës, në lidhje me përdorimin e dinarit serb, dhe cilat janë rezultatet e atyre inspektimeve. Por, pas më shumë se një javë pritjeje, ky institucion nuk ktheu përgjigje. Dogana e Kosovës, ndërkohë, ka njoftuar disa herë se ka ndaluar hyrjen e dinarëve nga Serbia në Kosovë, me arsyetimin se nuk e ka miratimin e BQK-së.

Me dy kartela bankare - të Serbisë dhe të Kosovës

Rada, nga Mitrovica e Veriut, tregon për Radion Evropa e Lirë se çdo ditë del për të blerë produktet e nevojshme - herë në dyqane, herë nga shitësit ambulantë që gjenden në afërsi të sheshit “Mbreti Llazar”. Ajo thotë se merr dy pensione - njërin nga Serbia në dinarë dhe tjetrin nga Kosova në euro. Ka dy kartela bankare - njërën të një banke në Serbi për t'i tërhequr dinarët dhe tjetrën të një banke në Kosovë për tërheqjen e eurove. Ajo thotë se blerjet i bën edhe me euro, edhe me dinarë. “Çfarëdo që të më gjendet në kuletë - nuk është me rëndësi a janë dinarë apo euro. Vetëm ua jep paratë dhe gjithçka në rregull”, thotë 77-vjeçarja. E sa iu përket shërbimeve të tjera, Rada thotë se pagesa dallon. “Telefonin e paguajmë me dinarë. Energjinë elektrike e paguajmë me euro. Largimin e plehrave e paguajmë me dinarë...”, thotë Rada. Dy kartela bankare, të Kosovës dhe të Serbisë, ka edhe Mishko Bojiq. Ai e merr pensionin e pleqërisë nga Kosova në euro dhe pensionin nga Serbia në dinarë. Për këtë të fundit thotë se shkuarja çdo muaj në Rashkë, është bërë e mundimshme. “Paguajmë karburantet ose autobusin... Nganjëherë presim me nga dy-tri orë në kufi”, thotë Bojiq. Ai, po ashtu, tregon se pjesën më të madhe të dinarëve duhet ta konvertojë në euro, pasi që shërbimet që i merr nga institucionet e Kosovës, duhet t'i paguajë në këtë valutë. “Situata që e ka krijuar Qeveria e Kosovës, që të mos përdoret dinari, është politikë dhe nuk është në rregull”, sipas tij.

Çfarë thotë BQK-ja?

Banka Qendrore e Kosovës “nuk ka një analizë në dispozicion, lidhur me llogaritë e hapura dhe shërbimet në bankat e

licencuara në veri të vendit”. Kështu iu përgjigj ky institucion interesimit të Radios Evropa e Lirë në lidhje me numrin e llogarive bankare, të hapura nga qytetarët në veri të Kosovës, dhe kërkesat e tyre për shërbime bankare. BQK-ja thekson vetëm se shërbimet financiare, tash e një vit, “ofrohen prej institucioneve financiare të licencuara dhe mbikëqyrura nga BQK-ja”. “Është vendosur kontroll i plotë i rrjedhës monetare brenda vendit, që i ka kontribuar rritjes se integritetit të sektorit financiar, reduktimit të rrezikut për financim të paligjshëm si dhe qasjes në shërbime të sigurta për të gjithë qytetarët”, thuhet në përgjigjen me shkrim. Aty, po ashtu, theksohet se nga fundi i vitit 2023, numri i institucioneve financiare, të cilat janë licencuar për të ushtruar aktivitetin e tyre në katër komunat veriore të vendit, “gati se është trefishuar”. “Deri në gusht të vitit 2023, numri i përgjithshëm i zyrave të institucioneve financiare në veri të vendit, ishte 17 - prej të cilave katër ishin zyra bankare, dy nga to në pikat kufitare. Me të dhënat aktuale, ky numër i përgjithshëm ka arritur në 46, prej të cilave 12 janë zyra bankare”, bën të ditur BQK-ja. Sipas BQK-së, prania bankare në veriun e Kosovës përfshin banka vendore dhe ndërkombëtare. Radio Evropa e Lirë iu drejtua disa prej tyre - përfshirë Raiffeisen Bank - për t'i pyetur se a janë shtuar aktivitetet bankare të qytetarëve në veri, por nuk mori përgjigje.

Rrjedhat monetare “të zhvendosura”

Nga organizata joqeveritare Qendra për Veprim Afirmativ Social (CASA), që funksionon në Mitrovicë të Veriut, thonë se që nga vendimi i autoriteteve të Kosovës për të ndaluar dinarin serb, qasja të paraja e qytetarëve serbë që jetojnë në veri të Kosovës, është vështirësuar. Kjo për faktin se, siç thonë,

shumica e të ardhurave që marrin qytetarët e kësaj zone, vijnë nga buxheti i Serbisë, i cili pagesat i bën me dinarë. Drejtuesi i CASA-s, Boban Simiq, flet më shumë për arsyet: “Për shembull, për fëmijët që i kam në çerdhe, duhet të paguaj në sistemin serb. Pagesën e çerddes nuk mund ta bëj me euro, më duhet ta bëj me dinarë. Por, këtë pagesë unë nuk mund ta bëj këtui”, thotë Simiq, duke shtuar se për të dhe pagesa të tjera të ngjashme shkon në Rashkë. Sipas tij, kjo nënkupton edhe zhvendosjen e rrjedhës monetare nga një vend në tjetrin - gjë që, siç thotë, e bën të pakuptimtë qëllimin e autoriteteve të Kosovës për ndalimin e dinarit serb. “Jemi dëshmitarë që Prishtina, edhe më tej, nuk ka mundësi t'i mbikëqyrë rrjedhat monetare. Nuk ekziston ajo mundësi, sepse ato janë zhvendosur. Nuk janë më këtu”, thotë Simiq për Radion Evropa e Lirë. Ai shton se rrugëdalje e vetme nga kjo situatë do të ishte të marrëveshje ndërmjet autoriteteve të Kosovës dhe Serbisë, në nivelin teknik, që do të mundësonte regjistrimin e ndonjë institucioni financiar të Serbisë në sistemin e Kosovës. Këtë ide që është përmendur edhe më herët, autoritetet e Kosovës e kanë kundërshtuar, duke thënë se synim është shtrirja e autoritetit të tyre në çdo pjesë të Kosovës. Heqja e dinarit, megjithatë, ka nxitur reagime të shumta nga Serbia dhe bashkësia ndërkombëtare, për faktin se komuniteti serb në Kosovë, prej vitesh, ka pranuar pagesa të ndryshme në dinarë nga Serbia. Çështja i ka lëkundur edhe raportet e Kosovës me disa aleatë perëndimorë, të cilët i kanë kërkuar pezullimin e rregullores së BQK-së derisa qytetarët e prekur të përshtaten me praktikën e re. Por, autoritetet në Kosovë nuk kanë lëshuar pe, ndërsa disa takime mes delegacioneve të Kosovës dhe Serbisë, në përpjekje për të arritur ndonjë marrëveshje për çështjen, kanë përfunduar pa sukses.

“NE NUK KEMI FRIKË NGA BOMBA”



Lucio CARACCIOLO

Të gjithë janë kthyer të flasin për bombën atomike, si garancinë e vërtetë të sigurisë për vendin e tyre. Pse Ukraina duhej të çmontonte arsenalin e saj në vitin 1996? A mund t'u besojmë “garancive” franceze dhe britanike?

Në vitin 1966, “I Giganti” këndonin “Noi non abbiamo paura della bomba” (Ne nuk kemi frikë nga bomba. Kjo ishte një moto, “ne nuk kemi frikë nga bomba”, e cila sot besoj se duhet vënë disi në dyshim, sepse bomba atomike rikthehet si protagoniste në këtë luftë në Ukrainë dhe në gjithçka që lidhet me negociatat që shpresojmë vërtet të fillojnë mes Rusisë, Ukrainës dhe Amerikës. Le të fillojmë me një lajm ndoshta pak të njohur. Pak më shumë se një vit më parë, inteligjenca amerikane zbuloi se Putini kishte vendosur të përdorte bombën atomike në hapësirë si një mjet frikësimi, një paralajmërim për Ukrainën, dhe se ishte ndalur në momentin e fundit nga partnerët e tij kinezë, të cilët i kishin thënë: “Po ku mendon se po shkon?” Ndoshta lajmi është i vërtetë, edhe pse informacionet e inteligjencës gjithmonë duhet marrë me rezervë, por na kujton një pikë thelbësore, domethënë që kemi kaluar nga faza e gjatë e frikësimit gjatë Luftës së Ftohtë, kur nga njëra anë ishin sovjetikët dhe nga ana tjetër amerikanët të

armatosur “deri në dhëmbë me bomba”, por me rregulla mjaft të qarta, që nuk do të duhej të përdorej dhe që shërbente vetëm si mjet frikësimi, si kërcënim për të parandaluar përdorimin e saj. Tani, përkundrazi, të gjithë, edhe gazetat, diskutojnë jo vetëm për bombën si frikësim, por edhe si një armë për t'u përdorur në terren ose, siç kemi parë, në hapësirë. Më tepër se kaq, duket se tashmë të vetmet shtete vërtet sovranë janë ato që disponojnë një arsenal bërthamor. Problemi është se ndërkohë këto shtete po shtohen dhe rrezikojnë të bëhen gjithnjë e më shumë, pikërisht sepse e shohin bombën atomike si garancinë e vërtetë të sovranitetit të tyre. Dhe këtu vijmë tek rasti i Ukrainës, që na kthen pas në vitin 1996, kur Ukraina, pasi kishte marrë garanci – ato garancitë e famshme të sigurisë për të cilat flitet gjithmonë – nga Amerika, Rusia dhe edhe nga vende të tjera, vendosi të çmontonte arsenalin e saj bërthamor. Më kujtohet që kur Ukraina u bë e pavarur, në vitin 1991, ajo kishte arsenalin e tretë bërthamor më të madh në botë. Në të vërtetë, ai ishte pjesë e arsenalit sovjetik dhe e kishte trashëguar nga BRSS. Rusët këmbëngulën, në marrëveshje me amerikanët, që Ukraina t'ia dorëzonte këtë arsenal, dhe rezultatin e kemi sot përpara syve. Por mund të marrim shumë shembuj të tjerë. Për shembull,

Libia e Gadafit, që ishte një hap larg armës bërthamore, hoqi dorë dhe e dimë mirë se si përfundoi. Për shembull, Iraku i Sadam Huseinit, e njëjta histori. Ndërsa, për shembull, e kundërta ndodhi me Korenë e Veriut, e cila krijoi arsenalin e saj bërthamor duke injoruar presionet amerikane, dhe sot, falë këtij arsenal, i frikëson të gjithë ata që do të dëshironin ta zhduknin regjimin e saj nga faja e dheut. Dhe në fund, vijmë te rasti ynë. Këto ditë kemi parë francezët dhe britanikët të tundin arsenalin e tyre bërthamor dhe të ofrohen si garantues, jo vetëm për Ukrainën, por për vendet evropiane në vend të amerikanëve. Dhe ja tek është, Macron, ja tek është Starmer, i detyruar të flasë për bombën e tij si një garanci për të tjerët, duke shkaktuar ndërkohë reagime të ndryshme. Aq e vërtetë është kjo, saqë, në një moment të caktuar, qeveria franceze është dashur të ndërhyjë zyrtarisht, kur tashmë po flitej për një marrëveshje të mundshme franko-gjermane për të ndërtuar një arsenal të përbashkët, për t'u mbrojtur me bombën franceze. Dhe qeveria franceze, përmes ministrit të saj të Mbrojtjes, Louis Cornu, ka deklaruar se Franca ruan sovranitetin dhe kontrollin e bombës, dhe i vetmi person i autorizuar për të shtypur butonin është Macron. Pra, ka shumë biseda dhe shumë pasiguri, mbi bombën që në mënyrë hipotetike duhet të mbrojtë si garanci ekstreme

Ukrainën, por mbi të gjitha vendet e NATO-s, në rastin kur amerikanët vendosin se nuk kanë më shumë dëshirë të kujdesen për ne. Kjo ndoshta është mirë të kujtohet, duke qenë se Italia në një lojë të tillë është jashtë loje, sepse nuk e ka bombën, edhe pse kemi tentuar ta kemi. Në vitin 1957, Italia mori pjesë në një projekt sekret që duhej të çonte në ndërtimin e një bombe Italo-Franko-Gjermane përmes një marrëveshjeje të firmosur në fshehtësi në shkretëtirën algeriane, në atë kohë franceze, nga qeveritë italiane, franceze dhe gjermane. Projekti dukej se po përparonte, kur ministri italian i Mbrojtjes në atë kohë, Emilio Taviani, vendosi të informonte amerikanët, sepse nuk ishte shumë dakord me këtë dhe, mbi të gjitha, mendonte se amerikanët nuk do ta pranonin. Rezultati? Projekti dështoi dhe bomba atomike sot nuk është as te gjermanët, as te italianët, por është te francezët, sepse gjenerali De Gaulle i jepte shumë rëndësi këtij instrumenti të sovranitetit, jo aq si një mjet ushtarak, por si një instrument politik për të shpallur madhësinë e Francës. Atëherë, pse po flasim për bombën? Sepse shumë në Evropë, veçanërisht në Evropën Lindore dhe Veriore, mendojnë se edhe nëse lufta do të përfundonte, edhe nëse do të arrihej një marrëveshje paqeje, rusëve nuk mund t'u besohet. Ata mund të bëjnë një pauzë, ndoshta edhe të gjatë, dhe më pas të vendosin

jo vetëm të marrin pjesën tjetër të Ukrainës deri në Kiev, por edhe të kërcënojnë vendet baltike, Poloninë, vendet skandinave, pra atë krah verilindor të NATO-s që gjithmonë ka qenë veçanërisht armiqësor dhe që rusët e shohin si një provokim të hapur, njësoj si polakët, suedezët dhe baltikët i shohin rusët. Këtu duhet të arrihet një mirëkuptim. Për momentin, sigurisht nuk kemi asnjë provë për ndonjë qëllim të Rusisë për të sulmuar këto vende, por mbi të gjitha një farë skepticizmi në lidhje me këtë planifikim strategjik të mundshëm rus, që vjen nga fusha e betejës. Të gjithë kemi parë në çfarë gjendje është sot, për fat të keq, Ukraina dhe, mbi të gjitha, sa të rraskapitur janë ukrainasit, por shohim më pak një të dhënë tjetër, që është se edhe nëse kjo luftë është e humbur për Ukrainën, sigurisht nuk është e fituar nga Rusia. Rusët e vranë janë qindra mijëra, opinionioni publik rus, që gjithsesi është shumë patriotik dhe i gatshëm të hajë bar kur është luftë, po fillon të mendojë se ndoshta është koha për ta përfunduar, për të mos rrezikuar më tej. Dhe kjo do të thotë se pas tre vitesh luftime, rusët nuk kanë arritur të marrin as edhe një qytet të madh ukrainas, e aq më pak Kievin. Pra, përtej synimeve të tyre, rusët mesa duket nuk kanë një kapacitet ushtarak të tillë sa të kërcënojnë fqinjët e tyre. / Limes – Bota.al



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Dalin në shitje biletat për ndeshjen Kosovë - Islandë

PRISHTINË, 11 MARS - Të martën kanë dalë në shitje biletat për ndeshjen e “play-off”-it të Ligës së Kombeve në mes të Kosovës dhe Islandës. Federata e Futbollit e Kosovës përmes faqes së

saj zyrtare në rrjetet sociale njoftoi se biletat tashmë janë në dispozicion për t'u blerë në sistemin online. Ato do të kushtojnë nga 5 euro deri në 80 euro, që është edhe çmimi i biletave të zonës

VIPKosova dhe Islanda do të përballen mes vete të enjten e 20 marsit në stadiumin “Fadil Vokrri” në Prishtinë, ndërsa loja do të fillojë prej orës 20:45. Më pas loja e kthimit do të luhet të dielën

në Spanjë, kur edhe do të përcaktohet Kombëtarja që do të luajë në Ligën B dhe ajo që do të përfundojë në Ligën C në edicionin e ardhshëm të Ligës së Kombeve.



Drita, fitore me aromë titulli ndaj Ballkanit, Ferizaj mposhti Llapin

EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 11 MARS - Skuadra e Dritës ka bërë një hap gjigant drejt titullit të kampionit në Superligën e Kosovës në futboll, pasi e ka mposhtur sot Ballkanin me rezultat 2-0. Kjo ndeshje i ka takuar javës së 24-t në elitën e futbollit të Kosovës.

Pjesa e parë ishte e qetë për nga rastet e krijuara për gol dhe në këtë mënyrë skuadrat shkuan në pushim me rezultat 0-0. Në minutën e 64-t Ballkani mbeti pa një lojtar, ku Gentrit Halili u ndëshkua me karton të kuq dhe këtë epësi numerike e shfrytëzoi për mrekulli skuadra

gjilnase. Në minutën e 77 Veton Tusha shënoi për rezultat 1-0. Për rezultat 2-0 është përkujdesur Kastriot Selmani, i cili realizoi në minutën e 89. Tash Drita është lidere, ka 13 pikë më shumë se Ballkani që zë vendin e dytë në tabelë. Forma jo e mirë e Llapit në Superligë po vazhdon, derisa ky klub të martën ka pësuar humbje nga Ferizaj me rezultat 2-1. Tre golat e kësaj ndeshje u shënuan në pjesën e parë. Pas njëmbëdhjetë minutave lojë, Valmir Nafiu realizoi për 1-0. Gjashtë minuta më vonë është kundërpërgjigjur Blendi Baftiu për shifrat 1-1. Tre minuta pa përfunduar pjesa e parë,



skuadra vendase e riktheu epërsinë me golin e Antonio Ilieski. Në pjesën e dytë u zhvillua lojë më e mbyllur dhe

rezultati final ishte ai i pjesës së parë 2-1. Pas këtyre tri pikëve, Ferizaj renditet në pozitën e pestë me 32 pikë, ndërsa Llapi i

teti me 26 pikë.

Sot (e mërkurë) do të zhvillohet një tjetër ndeshje interesante mes Malishevës dhe Gjilanit, kurse do të ballafaqohen edhe Prishtina dhe Dukagjini. Kjo xhiro përfundon të enjten me ndeshjen Suhareka - Feronikeli '74.

SUPERLIGA

14:00 Drita - Ballkani 2-0
14:00 Ferizaj - Llapi 2-1

Të mërkurën takohen:
12:30 Prishtina - Dukagjini
14:00 Malisheva - Gjilani

Të enjten takohen:
14:00 Suhareka - Feronikeli '74

Çdo gjë gati për dy ngjarjet e rëndësishme në hendboll

PRISHTINË, 11 MARS - Të martën në mesditë në lokalet e Federatës së Hendbollit të Kosovës është mbajtur konferencë për medie, në të cilën presidenti i FHK-së, Edin Kolgeci dhe sekretari i përgjithshëm, Muhamet Arifi, i kanë njoftuar gazetarët për dy ngjarjet e rëndësishme të kësaj jave. Prej së mërkurës deri të dielën në Prishtinë mbahet IHF Trophy Intercontinental për hendbollistët e grupmoshës U18 dhe U20.

“Është kjo ngjarje me rëndësi shumë të madhe në të cilën ne prezantohemi me Kombëtaren U18. Fituesi kualifikohet në



Kampionat Botëror dhe ky është synimi ynë”, ka thënë presidenti Kolgeci. Gjithsej luhen 22 ndeshje,

ndërsa finale të dy grupmoshat janë të dielën. Te 18-vjeçarët të mërkurën janë ndeshjet Uzbekistani -

Nikaragua (15:00) dhe Kaledonia e Re - Nigeria (17:00). Të enjten janë ndeshjet ShBA-ja - Nikaragua dhe Nigeria - Kosova, që fillon në orën 17:00. Te 20-vjeçarët të mërkurën janë ndeshjet Kaledonia e Re - Bullgaria (11:00) dhe Uzbekistani - Nikaragua (13:00). Marrin pjesë edhe ShBA-ja dhe Ruanda. Në konferencë u fol edhe për ndeshjet e Përfaqësueses A të Kosovës me Ukrainën. Ndeshja e parë është të enjten prej orës 20:15 në Pallatin e Rinisë dhe Sportit në Prishtinë. Ndeshja tjetër luhet të dielën në Lituani. “Ndeshjet janë kualifikuese për

Evropian dhe me rëndësi shumë të madhe. Në rast të fitores në Prishtinë i afrohemi shumë qëllimit të madh. Kosova po punon me përkushtim maksimal, ndërsa presim edhe përkrahje nga shikuesit. Terminin e ndeshjes është shumë i përshtatshëm, kështu që shpresojmë që të ketë sa më shumë tifozë në palestër”, ka thënë sekretari i përgjithshëm Arifi. Thirrje për përkrahje nga shikuesit dhe mediet ka bërë edhe presidenti Kolgeci. Ai ka thënë se FHK-ja është angazhuar maksimalisht dhe i ka bërë të gjitha përgatitjet për këto dy ngjarje.

Spartak Moska dhe Zeniti refuzojnë transferimin e Dakut për arsye politike

MOSKË, 11 MARS - Dy klubet e mëdha ruse, Spartak Moska dhe Zenit St. Petersburg, thuhet se kanë refuzuar transferimin e sulmuesit shqiptar Mirlind Daku nga Rubin Kazani për arsye politike. Daku ka qenë një nga lojtarët më të mirë në kampionatin rus që nga

transferimi i tij nga Sllovenia, por kalimi te ndonjë klub më i madh rus po has në vështirësi. Sipas mediumit rus “Sport Express”, Spartak Moska dhe Zenit St. Petersburg kanë pasur mundësinë ta blejnë sulmuesin e Rubin Kazanit, Mirlind Daku, por në të dyja

rastet klubet kanë vendosur ta refuzojnë blerjen e lojtarit. Ky medium shton se si klubi nga kryeqyteti ashtu edhe ai nga Shën Petersburgu e konsideruan një transferim të tillë politikisht jo të besueshëm. Daku luan për Rubinin që nga vera e vitit 2023. Këtë sezon futbollisti

shqiptar 27-vjeçar ka luajtur 21 ndeshje në të gjitha garat dhe ka shënuar 11 gola dhe ka bërë 6 asistime. Kontrata e tij është e vlefshme deri në verën e vitit 2026. Sipas faqes së specializuar të transferimeve “Transfermarkt”, Daku vlerësohet 7 milionë euro.



Denveri mposht kryesuesit e Oklahomas, zhgënjejnë lakersat

OKLAHOMA, 11 MARS - Denveri ngjitet në vendin e dytë në Konferencën e Perëndimit pas fitores me rezultat 140-127 ndaj kryesuesve të Oklahomas. Një ndeshje spektakolare, ku Nikola Jokiqi realizoi 35 pikë e Murray 34 pikë për miqtë. Humbja e dytë radhazi për lakersat, që u

mundën me rezultat 111-108 në fushën e Brooklynit. Vendimtar stoli i skuadrës vendëse, nga erdhën 44 pikë. Humbet edhe Miami, që në fushën e vet u mund me rezultat 105-102 nga Charlotte (Bridges 35 pikë). Ngjit shkallët në renditje ekipi i Golden States, që mundi me

rezultat 130-120 Portlandin (4 lojtarë realizuan mbi 20 pikë). Fitoi edhe skuadra e Memphisit, që falë 29 pikëve të Ja Morantit, mundi me rezultat 120-118 Pheonixin në sekondat e fundit. Rezultatet: Atlanta-Philadelphia (132-123), Boston-Utah Jazz

(114-108), Brooklyn-Lakers (111-108), Miami-Charlotte (102-105), Toronto-Washington (119-104), Chicago-Indiana (121-103), Houston-Orlando (97-84), Memphis-Phoenix (120-118), Oklahoma-Denver (127-140), San Antonio-Dallas (129-133), Golden State-



Portland (130-120), Sacramento-NewYork (104-133).

Sot zhvillohen ndeshjet e fundit para Final 4 në Ligën Unike



PRIZREN, 11 MARS - Të mërkurën zhvillohet xhiroja e gjashtë në Ligën Unike të Meshkujve, që është edhe java e fundit për garat e rregullta. Pas përfundimit të garave të rregullta, do të përcaktohen katër skuadrat që do të jenë pjesë e Final 4, që zhvillohet në Kosovë. Nga dy grupet kualifikohen dy skuadrat e para

në renditje. Në Grupin A Bashkimi do të përballlet me Teutën, dy skuadrat e fundit në këtë grup dhe që kanë një ndeshje më pak të zhvilluar. Prizrenasit kanë një fitore e tri humbje, derisa durrsakët katër humbje në po aq ndeshje. Në Gjakovë përballen Besëlidhja dhe Vëllaznimi, dueli për vendin e parë, pasi të dyja

LIGA UNIKE - JAVA 6

Grupi A

Të mërkurën takohen:
19:00 Bashkimi - Teuta
19:00 Besëlidhja - Vëllaznimi

Grupi B

19:00 Tirana - Sigal Prishtina
19:00 G. Eagle Ylli - Vllaznia

skuadrat kanë nga katër fitore dhe një humbje. Në Grupin B përballen dy skuadrat kryeqytetase, Tirana dhe Sigal Prishtina, takim që zhvillohet në palestrën “1 Tetori” në Prishtinë. Tiranasit kanë dy fitore e tri humbje, derisa prishtinasit tri fitore e dy humbje. Takimi tjetër i këtij grupi është mes Golden Eagle Yllit dhe Vllaznisë, ku therandasit kanë tri fitore e dy humbje, ndërsa shkodranët dy fitore e tri humbje.

Shefi i Mercedesit: Për ne po fillon një kapitull i ri pa Hamiltonin

SHTUTTGART, 11 MARS - Lewis Hamiltoni është larguar nga Mercedesi pas 12 vitesh. Shtatë herë kampioni i botës tani vesh kostumin e Ferrarit, ndaj për makinën gjermane fillon një epokë e re. I këtij mendimi është shefi i Mercedesit, Toto Wolff, që në krah të George Russellit tashmë ka 18-vjeçarin italian Kimi Antonelli. Për herë të parë anglezi do ta gjejë veten në rolin e “veteranit”, ndërsa italianin është i ri dhe i talentuar, por duhet të dëshmojë që nga kjo fundjavë në pistën australiane. “Në Australi ne do t’i shkruajmë rreshtat e parë të kapitullit tonë të ardhshëm. Vitet e ardhshme do të përpiqemi të vendosim standarde të reja dhe të realizojmë ëndrra të reja. Kjo do të na përfshijë të gjithëve, nga pilotët te mekanikët, të gjithë



në Brackley dhe Brixworth dhe natyrisht fansat tanë”, ka thënë Wolff. “Me George dhe Kimi, dy talentë të rritur në shtëpi nga programi ynë i të rinjve, ne kemi një linjë të fortë pilotësh që ndërthurin përvojën, rininë dhe shpejtësinë. Kjo është një dyshe emocionuese që do të na çojë në epokën tonë të ardhshme. Këtë fundjavë do të

kemi një pasqyrë më të qartë për këtë”, ka shtuar Toto Wolff. Duke folur për rivalët, ai ka shtuar: “Rivalët tanë e përfunduan sezonin 2024 në një nivel të lartë dhe e dimë se Ferrari, Red Bulli dhe Mc Lareni në veçanti duhet të kenë një avantazh të hershëm ndaj performancës sonë. Jemi të kënaqur me punën e bërë jashtë sezonit dhe testet në Bahrein”.

SHKURT

Përfundon sezoni për Gjokajn

FC Prishtina ka njoftuar se sezoni ka përfunduar për portierin Altin Gjokaj. Ky i fundit është lënduar në stërvitje dhe do t’i nënshtrohet një operacioni. “Altin Gjokaj humb sezonin. Portieri i ekipit tonë ka pësuar një lëndim gjatë seancës stërvitore dhe pas ekzaminimeve mjekësore është konstatuar se ka dëmtim të miniskusit të gjurit. Në këtë mënyrë Gjokaj duhet t’i nënshtrohet operimit dhe rrjedhimisht do ta humbë pjesën e mbetur të sezonit. Gjokajt i urojmë rikthim sa më të shpejtë në fushë”, thuhet në njoftimin e FC Prishtina.

Rikthehet Zhegrova, ushtron individualisht

Edon Zhegrova është afër rikthimit në fushën e blertë pas lëndimit që e kishte pësuar në fund të vitit të kaluar. Nga ajo kohë, “Messi i Kosovës” ka vuajtur shumë pasi nuk po mund ta bënte atë që di më së miri dhe që e do më së shumti. “Një tjetër lajm i mirë, rikthimi i Edon Zhegrovës në stërvitje individuale”, njoftoi klubi francez për rikthimin e 25-vjeçarit, i cili disa ditë do të ushtrojë individualisht para se t’i bashkohet ekipit në stërvitje, kur edhe do të jetë gati për t’u rikthyer në ndeshje zyrtare. Zhegrova është i vendosur ta rikthejë formën optimale dhe ta tregojë veten në muajt e fundit të përvojës në Lille para transferimit në një klub më të madh evropian, e cila pritet të ndodhë në verën e ardhshme. Fatkeqësisht, futbollisti ofensiv nuk do të mund ta ndihmojë Kosovën në dy ndeshjet e rëndësishme kundër Islandës në këtë muaj, në “play-off” të Ligës së Kombeve.

Motta rrezikon shkarkimin, Juve ka në listë Gasperinin, Allegrin dhe Conten

Dhjetë ndeshjet e fundit në Serinë A do të jenë përcaktuese për të ardhmen e trajnerit Thiago Motta. “Corriere dello Sport” raporton se e vetmja gjë që mund ta shpëtojë Mottan nga shkarkimi është kontrata e tij e majme e firmosur në fillim të këtij sezoni deri më 2027. Sigurisht për Juven, nëse vendosin ta shkarkojnë Mottan, do të jetë një barrë jo e lehtë financiare. Në anën tjetër në Itali qarkullojnë lajme se Juventus ka menduar edhe për pasardhësin e Mottas, ku në listë janë Gasperini, Allegri dhe Conte.

Përfundon pezullimi i Pogbas

Paul Pogba mund të rikthehet zyrtarisht në fushë pas një viti e gjysmë ndalimi të detyruar, i shkaktuar nga rezultati pozitiv me doping pas ndeshjes Juventus-Udinese më 20 gusht 2023. Pogba fillimisht ishte pezulluar për katër vjet, por Gjykata e Arbitrazhit Sportiv (TAS) ia uli dënimin në 18 muaj. 11 marsi 2025 ndoshta shënon fundin e periudhës më të vështirë në jetën e kampionit të botës 2018, e cila përfshinte edhe rastin e rrëmbimit dhe shantazhit që ai pësoi në mars të vitit 2022. Tani Pogba mund të mendojë më në fund vetëm për futbollin dhe ka filluar t’i shqyrtojë opsionet për të vendosur ku do ta vazhdojë karrierën. Pogba, në moshën 31-vjeçare, ka ende shumë për të ofruar dhe tani është gati të rikthehet në lojë me një objektiv madhor: ta rifitojë fanellën e kombëtares franceze dhe të luajë në Kupën e tij të tretë të Botës, pasi u detyrua të heqë dorë me keqardhje nga ajo e vitit 2022.

Unitedi zbulon projektin e stadiumit të ri me kapacitet 100 mijë vende

Manchester Unitedi ka zbuluar të martën planet për ta ndërtuar stadiumin më të madh të futbollit në botë. Arena me 100 mijë vende do ta kalonte “Wembleyn” si arena më e madhe në Mbretërinë e Bashkuar. 20 herë kampioni i Anglisë tha se do ta ndërtonte stadiumin në afërsi të stadiumit

ikonik “Old Trafford”. Është raportuar se kështu Unitedi nuk do të ketë nevojë të zhvendoset diku tjetër gjatë procesit të ndërtimit të stadiumit të ri. “Stadiumi aktual na ka shërbyer shkëlqyeshëm për 115 vjet, por ka mbetur prapa arenave më të mira në sportin botëror”, ka thënë një

prej pronarëve Jim Ratcliffe. “Duke ndërtuar pranë zonës ekzistuese, ne do të jemi në gjendje ta ruajmë thelbin e ‘Old Trafford’-it, ndërsa krijojmë një stadium vërtet të avancuar, që transformon përvojën e tifozëve tanë vetëm pak hapa larg nga shtëpia jonë historike”, ka shtuar

Ratcliffe. Unitedi nuk ka treguar se sa do të kushtojë stadiumi dhe se kur do të përfundojë ai. Arkitekti Norman Foster ka treguar se punët do të zgjasin pesë vjet. Miliarderi Ratcliffe pagoi 1,3 miliard dollarë për 25 për qind të aksioneve të klubit vitin e kaluar, ndërsa ndërtimin e stadiumit të ri

e ka prej prioriteteve. Mundësia e rindërtimit të stadiumit aktual u shqyrtua, por është vendosur për stadium plotësisht të ri. “Sot shënojmë fillimin e një udhëtimi tepër emocionues drejt ofrimit të atij që do të jetë stadiumi më i madh i futbollit në botë”, ka vazhduar Ratcliffe.



KOMPANIA REGIONALE E MBETURINAVE

"Ambienti" SH.A. PEJË

NR. 646

DATA 14.03.25

Ndërrmarrja Publike Lokale

KRM "Ambienti" Sh.A. Pejë

Njësia Operative Pejë, Klinë, Istog.

Zyret Qendrore Adresë Rr.Xhem Sadrija pn, Fusha e Pejës-Tranzit KK Pejë

ANULOHEK KONKURSI

Anulohet konkursi i datës 04.03.2025 për pozitën Kontroller i Brendshëm (inspektor) vendi i punës Pejë.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania "Rizam Holding" Sh.p.k Mamushë, Prizren në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për vendosjen e paneleve diellore fotovoltaike me kapacitet 199.65 KVP, mbi pallati 02-zona kulmi juglindor në Prianë, Prizren.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 30.04.2025 në ora 10:00 në Shkollën Fillore dhe e Mesme e Ulët "22 Dëshmorët", në Randobravë, Prizren do të organizohet debat publik nga Kompania "Rizam Holding" Sh.p.k Mamushë, Prizren në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën elektronike


Linku për Zoom: <https://us05web.zoom.us/j/7012651943?pwd=JsyiMPR68piZDwwrm2Z53eU1x9TEbu.1>
Meeting ID: 701 265 1943
Passcode: 123456

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë "Rizam Holding" Sh.p.k Mamushë, Prizren për vendosjen e paneleve diellore fotovoltaike me kapacitet 199.65 KVP, mbi pallati 02-zona kulmi juglindor në Prianë, Prizren.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnv.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook  www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Arianit Hoxha nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Q.M.M. "Hajdar Dushi" Gjakovë.
- Qendra Rekreative "Pallma" B.I. nga Gjakova shpall të pavlefshme numrin Unik Identifikues 811608259 të lëshuar nga ARBK.
- Maurita Koca nga Bishtazhina KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të Gjimnazit "Hajdar Duishi" Gjakovë.
- Bedri Zeneli nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën dhe certifikatën e notave të Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.
- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)
- Lëshoj banesë me qira, pent-house. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.
- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.
- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

